



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0494

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga, Isa Hasani-Kryetar, Batisha Ibrahim- Anëtare dhe Vedat Poterqoi-Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së OE CONSTRUMAX SH.P.K., kundër Njoftimit e kontratës ose me dokumentet e tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “FASADIMI I NDËRTESAVE TË VJETRA NË KRYEQYTET SI DHE OFRIMI I SHËRBIMEVE” me numër të prokurimit; 616-24-4375-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Kuvendi i Komunes Prishtines, më 21/08/2024, mori këtë:

Vendim

1. Refuzohet, si e pabazuar ankesa e CONSTRUMAX SH.P.K. me nr. 2024/0494 , e datës 10/06/2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Fasadimi i Ndërtesave të Vjetra në Kryeqytet si dhe Ofrimi i Shërbimeve”, me numër të prokurimit; 616-24-4375-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Kuvendi i Komunes Prishtines.
2. Mbetet në fuqi, “Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues”, i Autoritetit Kontraktues, Kuvendi Komunes Prishtinës, lidhur me aktivitetin e prokurimit nr; 616-24-4375-2-1-1.
3. Në përputhje me nenin 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues” CONSTRUMAX SH.P.K.” i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 02.05.2024 Komuna e Prishtinës, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Fasadimi i Ndërtesave të vjetra në Kryeqytet si dhe Ofrimi i Shërbimeve” me nr. të prokurimit: "616-24-4375-2-1-1".

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës shërbim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 500,000.00 €.

Me 31.05.2024 OE "Construmax Sh.P.K." ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 07.06.2024 Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 10.06.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE "Construmax Sh.P.K." me nr. 494/2024 lidhur me aktivitetin "Fasadimi i Ndërtesave të vjetra në Kryeqytet si dhe Ofrimi i Shërbimeve" me nr. të prokurimit: "616-24-4375-2-1-1".

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Construmax Sh.P.K." janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i parë (I) : "Supozojmë që kriteret e vendosura, pozicionet në paramas janë në kundërshtim me nenin 54 përkatësisht piken 54.7 të RrPP-së nr. 001/2022 citoj Neni 54 - Kontratat Kornizë ,, 54.7 Kontraktues para inicimit të aktivitetit të prokurimit duhet të siguroj nëse kontrata kornizë publike është qasja më e mirë për prokurimin përkatës. Autoriteti kontraktues duhet të Autoriteti sigurohet nëse përdorimi i kontratës publike kornizë synon nxjerrjen e vlerës së parasë së dhënë duke marr parasysh natyrën e prokurimit si dhe aftësinë që të specifikoj prokurimin me përpikëri të mjaftueshme qysh në fillim." Konsiderojmë që inicimi i këtij aktiviteti të prokurimit nuk mund të siguroj qasje më të mirë të prokurimit dhe nuk mund të bëjë nxjerrjen e vlerës së parasë së dhënë, pasi që paramasa e publikuar mundëson OE fitues të zgjedhe pozicionet e lehta dhe kryesisht pozicionet hulumtues, raporteve dhe projektimit të kryej, dhe ka lehtësisht të shmanget pozicioneve kryesore të këtij projekti Fasadës. Andaj bazuar në këtë sqarim konsiderojmë që përpilimi i kësaj kontrate nuk mund të siguroj qasje të mire dhe nuk mund të bëhet nxjerrja e vlerës së parasë së dhënë.."

Pretendimi i dytë (II) : " Supozojmë që kriteret e vendosura, pozicionet në paramas janë në kundërshtim me nenin 54 përkatësisht piken 54.10 të RrPP-së nr. 001/2022 citoj Neni 54 - Kontratat Kornizë ,, 54.10 Sasia e parashkuar e specifikuar në dokumentet e tenderit është vetëm sasi indikative. Kurdo që Autoriteti kontraktues specifikon sasinë indikative, Autoriteti kontraktues do të specifikojë në dosjen e tenderit vlerën ose sasinë e kontratës si një prag apo një tavan dhe do të lejojë devijimin prej tij, duke deklaruar gjithashtu përqindjen e mospërputhjes së lejuar. Mospërputhja e lejuar nuk mund të jetë më e lartë se plus/minus tridhjetë përqind (30%). Nëse AK nuk deklaron përqindjen e mospërputhjes në dosje të tenderit, atëhere kontrata përfundon me vlerën ose sasinë e kontratës si një prag apo një tavan të vendosur. Nëse AK deklaron përqindjen e mospërputhjes në dosje të tenderit dhe nëse urdhër blerjet tejkalojnë sasinë totale indikative ose vlerën totale indikative tëkontratës publike kornizë (duke përfshirë + tridhjetë përqind (30%), pa marrë parasysh datën origjinale të skadimit të Kontratës Publike Kornizë, kontrata do të ndërpritet automatikisht. Mospërputhja e lejuar plus/minus tridhjetë përqind (30%) vlen edhe për Lote dhe për pozicion/artikull, dhe në rast të arritjes se pragut të lejuar AK nuk mund të bëjë porosi tjera për atë Lot apo pozicion/artikull.." Konsiderojmë që inicimi i këtij aktiviteti të prokurimit në mungesë të sasive të parashkuara apo sasive indikativë lejon që OE fitues të bëjë përzgjedhjen e pozicioneve të cilat ka leverdi. Po ashtu konsiderojmë që DT dhe Paramasa nuk janë në përputhje me nenin 54 të RrPP-së nr 001/2022 pasi që mungojnë sasi të indikativë."

Pretendimi i tretë (III) : "Supozojmë që kriteret e vendosura, pozicionet në paramas janë në kundërshtim edhe me nenin 1 të LPP-së citoj : Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe

burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla. 5/8 Konsiderojmë që përpilimi i DT dhe paramasës nuk mund të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë, për të cilat jeni të obliguar të zbatoni rregullat dhe ligjet për të pasur një çmim sa më ekonomik dhe të arsyeshme për secilën lëndë të prokurimit. Forma e publikimit të kësaj kontrata e cila ka formën së çfarë të donë OE fitues mund të projektoj, e çfarë do mund të hulumtoj, e çfarë do raporti mund të përpiloj, e çfarëdo punë mund të kryej, konsiderojmë që nuk mund të sigurohet zbatimi i nenit 1 të LPP-së.”

Pretendimi i katërt (IV) : “Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale - Kapaciteti teknik dhe profesional: pika 5 ,, OE te këtë një inxhinier i elktros me provoj pune 10 vite pas diplomimit, i cili ka provoj pune ne efijencë te energjisë si auditime te energjisë, hartimin e politikave te energjisë si PVKEQ, PVKEK ne Komuna si dhe raporte e auditimit te energjisë ne ndriçim publik dhe ndërtesa. Dëshmia e kërkuar dokumentare 5. Referencat duhet te jen te lëmes se njëjtë. Ing. duhet te jete i certifikuar si auditor i energjisë dhe i certifikuar për performancën e energjisë ne ndërtesa te softuerit EPCSoftwareKosovo ose iSBEMXK. Diploma e inxhinierit , CV si dhe Marrëveshjen mbi angazhimin e tij Pika 6 Një ing. te elektros me provoj pune 10 vite pas diplomimit, me provoj pune ne hartimin e politikave te energjisë si PVKEQ, PVKEK ne Komuna. Referencat duhet te jenë te lëmes se njëjtë. Ing. duhet te jete i certifikuar si auditor i energjisë dhe i certifikuar për ndërtesa te softverit EPCSoftwareKosovo ose iSBEMXK. Dëshmia e kërkuar dokumentare 6. Referencat duhet te jen te lëmes se njëjtë. Ing. duhet te jete i certifikuar si auditor i energjisë dhe i certifikuar për performancën e energjisë ne ndërtesa te softverit EPCSoftwareKosovo ose iSBEMXK. Diploma e inxhinierit , CV si dhe Marrëveshjen mbi angazhimin e tij Pika 7. Një Arkitekt ose ing. i ndërtimtarisë me provoj pune 5 vite pas diplomimit, për hartimin e politikave te energjisë si PVKEQ, PVKEK ne Komuna. Referencat duhet te jen te lëmes se njëjtë. Arc. ose Ing. duhet te jete i certifikuar si auditor i energjisë dhe i certifikuar për ndërtesa te softverit EPCSoftëareKosovo. Dëshmia e kërkuar dokumentare 7. Referencat duhet te jen te lëmes se njëjtë. Arc. ose Ing. duhet te jete i certifikuar si auditor i energjisë dhe i certifikuar për ndërtesa te softverit EPCSoftëareKosovo. Diploma e inxhinierit , CV si dhe Marrëveshjen mbi angazhimin e tij Konsiderojmë që kërkesat lidhur me stafin inxhinierit që të kenë certifikata të softverit EPCSSoftwareKosovo ose iSBEMXK është kërkesë diskriminues dhe kufizuese vetëm në dy softuer, duke pasur parasysh që ekzistojnë me qindra softuerë në botë lidhur me kalkulimin e energjisë, po ashtu analizat dhe kalkulimit e masave të evidencës mund të bëhen edhe me kalkulimi me dorë dhe softuer tjerë. Andaj kërkojmë që kjo kërkesë mos të kufizohet vetëm në dy softuer. Gjithashtu përvoja e kërkuar prej 10 viteve është përvojë e panevojshëm, pasi që do të ishte e mjaftueshme një përvojë 3-5 vite nëse ka trajnimet e kryera të efijencës. Këto kërkesa bien ndesh plotësisht me nenin 7 të LPP-së përkatësisht paragrafët 1, 2, 3 dhe 6. Paragrafi 1 i nenit 7 parasheh qartë që “Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente”. Me këto kërkesa, jo që nuk mund të ketë trajtim të barabartë të operatorëve ekonomik por do të ketë diskriminim të hapur dhe përcaktim të fituesit qysh në start të këtij aktiviteti të prokurimit, pa konkurrencë të hapur. Paragrafi 6 i dispozitës së nenit 7 parasheh qartë : Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit”. Me këto kërkesa nuk mundësohet pjesëmarrje e gjerë e operatorëve ekonomik, por në këtë mënyrë është kufizuar tej mase konkurrenca dhe këto kërkesa janë drejtpërdrejtë jo në harmoni me çmimin dhe lëndën e prokurimit sepse kur 6/8 kufizohet konkurrenca me kërkesa të pa nevojshme atëherë edhe çmimi ofertues i operatorëve ekonomik të favorizuar automatikisht është shumë më i lartë sepse nuk kanë konkurrencë dhe faktikisht determinohet çmimi nga ana e autoritetit kontraktues në bazë të kërkesave të dosjes së tenderit. Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe kundërshtimet tona që u cekën më lartë rezulton autoriteti kontraktues nuk e ka përpiluar dosjen e tenderit në harmoni me nenin 27 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk e keni pasur parasysh as nenin

18.9 të RRUOPP ku shkruan qartë që “Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë që nuk: Kufizon konkurrencën në mesin e OE, ose Diskriminon kundër ose vepron në favor të një ose më shumë OE-ve. Pra duke u bazuar në të gjitha faktet që u cekën më lartë shihet tendenca e AK-së për dhënien e kontratës operatorëve ekonomik të caktuar, pasi që gjitha kërkesat e lartpërmendura i përshtaten kompanive të caktuara dhe kufizohet konkurrenca. Bazuar në Rregullore Nr.001/2022 për prokurimin publik Neni 17 Dosja e Tenderit paragrafi 17.34 17.34 Në rast të aplikimit të kontratës kornizë ku sasi të mund të mos jenë parashikuar në mënyrë precize një parashikimi i përafërt i sasive duhet të përfshihet. Parashikimi i tillë i përafërt mund të bazohet në konsumin e mëhershëm duke e korrigjuar me variacionet e njohura sipas nevojës. Sasi të duhet të kenë për aq sa është e mundur afatet e dorëzimit. Neni 54 Kontrata Kornizë paragrafi 9 Autoriteti kontraktues nuk mund të përdor kontratat publike kornizë në mënyrë të tillë që të .parandaloj dhe kufizoj konkurrencën. Pra me këto kërkesa dhe dëshmi të kërkuara mundësia është shumë e madhe dhe pothuajse e pashmangshme e dëmtimit të buxhetit, sepse kompanitë e caktuara (favorizuese) mund të ofertojnë me çmime shumë më të larta dhe eventualisht të nënshkruajnë kontratë, prandaj mundësia e manipulimit me çmime kur përshtaten kërkesat është shumë e madhe. Duke u bazuar në të gjitha ato kërkesa diskriminuese-favorizuese dhe në ato dëshmi të kërkuara, rezulton se në këtë mënyrë nuk mund të arrihet qëllimi i LPP-së, siç parashihet në nenin 1 të këtij ligji, e ku shkruan qartë: Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efektive, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë. Kërkesat e lartcekura bien në kundërshtim me nenin 7 paragrafi 1, 3, 4 dhe 6 të LPP-së, sepse në këta paragraf parashihet qartë që operatorët ekonomik nuk mund të diskriminohen në asnjë mënyrë dhe në asnjë variant. Prandaj kërkesat të cilat i kontestuar më lartë duhet larguar/ndryshuar për të pasur një aktivitet të prokurimit normal dhe për të mos u diskriminuar/favorizuar kompanitë e caktuara. Kërkesat që u kundërshtuan më lartë, janë shumë favorizuese/diskriminuese dhe njëkohësisht ua mbyllin dyert e ofertimit shumë kompanive me eksperiencë në këtë fushë dhe gjithashtu këto kërkesa bijnë në kundërshtim edhe me nenin 26.4 të Rregullave dhe Udhëzuesit operativ për prokurim publik, sepse aty shkruan qartë se “Gjatë përcaktimit të kërkesave minimale për kualifikim, AK do të kushtoj rëndësi të veçantë zhvillimit të OE dhe do të formuloj kërkesat minimale të kualifikimit në mënyrë që nuk përjashton OE të themeluar rishtazi të cilët posedojnë aftësi të arsyeshme dhe të mjaftueshme ekonomike, financiare dhe/ose teknike”. Me këto kërkesa, jo vetëm që nuk i është kushtuar rëndësi të operatorëve ekonomik të ri, por i është kufizuar konkurrenca edhe operatorëve ekonomik me përvojë dhe me stabilitet ekonomik financiar dhe me aftësi teknike profesionale, prandaj duhet ndryshuar/larguar këto kërkesa që të mundësohet pjesëmarrje më e gjerë e operatorëve ekonomik në këtë aktivitet të prokurimit. Pra autoritet kontraktues në vend se të ketë parasysh edhe zhvillimin e operatorëve ekonomik të rinj, AK-ja përveç se nuk e ka marr parasysh këtë dispozitë, ata kanë diskriminuar hapur edhe operatorët ekonomik tjerë më shumë përvojë në këtë fushë siç është ky aktivitet i prokurimit. Krejt në fund, kur kemi parasysh të gjitha faktet dhe dëshmitë që u përmendën më lartë dhe kërkesat favorizuese/diskriminuese, ju njoftojmë se nëse nuk ndryshohen këto kërkesa, ne nuk do të ndalemi me këtë kërkesë për rishqyrtim por do të vazhdojmë procedurat ligjore edhe në institucionet tjera administrative por njëkohësisht më pastaj këto veprime dhe këto kërkesa do të denoncojmë në organet tjera kompetente me qëllim që të njoftohen edhe institucionet tjera kompetente se në këtë rast ka kurdisje të plotë të këtij tenderi.”

Përgjigje ne kërkesën për rishqyrtim:

“Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit, fillimisht duhet cekur se përmes nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njëzia kërkuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe parallogarinë. Përmes nenit 11 paragrafit 11.3 të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit ndër të tjera në bashkëpunim me njësinë kërkuese i koordinon dokumentet, projektet, specifikimet, termat e referencës, paramasat, parallogaritë dhe vizatimet. Në këtë rast zyrtari përgjegjës i prokurimit i ka falur besimin e plotë njësisë kërkuese lidhur me përcaktimin e paramasës së bashkangjitur me dosjen e tenderit në këtë aktivitet të prokurimit. Si e tillë paramasa reflekton tërësisht qëllimin por edhe domosdoshmërinë e këtij aktiviteti të prokurimit. Sa i përket kërkesave lidhur me stafin inxhinierik, duke marrë parasysh natyrën konkrete dhe qëllimin e këtij aktiviteti të prokurimit, kërkesa e parashtruar si të tilla janë të domosdoshme për të

realizuar me sukses kontratën që synohet të lidhet përmes kësaj procedure të prokurimit. Në anën tjetër as parashtruesi nuk ka parashtruar ndonjë dëshmi apo argument konkret sipas të cilit do të mund të vërtetohej e kundërta. Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi. Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP. Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.”

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 12/06/2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 494/2024, ndërsa me datë 24/06/2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/494 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK deklaroi se Pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE Nuk Pajtohet lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Lidhur me pretendimet e OE “Construmax Sh.P.K.” eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/494 ka vlerësuar si në vijim:

Konstatimi i parë (I): “Eksperti fillimisht sqaron se konform nenit 9 të LPP-së, është përgjegjësi e AK para se të fillohet me ushtrimin e çfarëdo aktiviteti të prokurimit, të bëjë vlerësimin formal të nevojave për një aktivitet të prokurimit. Gjithashtu përcaktohet se ZKA i AK duhet të sigurojë që të bëhet një vlerësim formal i nevojave ku përcaktohen lloji dhe përmasat e sakta të nevojave të veçanta të AK që prokurimi i propozuar parasheh t’i plotësojë; vlera e parashikuar, lloji i propozuar dhe kushtet përmbajtësore të kontratës publike që do të jenë lëndë e prokurimit të planifikuar; specifikimet e propozuara funksionale të secilit objekt që do të përfshihet nga një kontratë e tillë. Kështu pa prejjudikuar eksperti i merr si të mirëqena vlerësimet e AK-së se nuk kanë mundur të përcaktohen sasitë fikse apo indikativë, si rrjedhojë kontrata implementohet në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit-kontratës. Sipas sqarimeve të dhëna për rrethanat që lidhen me këtë çështje është e qartë se AK duke mos i ditur sasitë indikativë ka vepruar në përputhje me në paragrafin 15 të nenit 54, të RrPP, duke grupuar kështu artikujt në grupe dhe rrjedhimisht i ka dhënë peshën përkatëse 2 grupeve (grupi A 70% dhe grupi B 30%) të artikujve ku pesha totale është 100 %. Për me tepër edhe KRPP përmes interpretimit të sipërpërmendur ka zberthyer çështjen e kontratës kornizë kur nuk dihen sasitë indikativë. Andaj, pretendimi ankimor është i pabazuar.”

Konstatimi i dytë (II) : “Lidhur me këtë pretendim eksperti sqaron se OE ankues i konteston kërkesat sa i përket viteve të përvojës dhe certifikimit të stafit në softuerët EPCS Software Kosovo ose iSBEMXX. Fillimisht lidhur me vitet e përvojës, OE ankues i referohet kërkesave fillestare përkundër që të njëjtat sikurse është sqaruar me sipër në njoftimin e AK-së të datës 29.05.2024 janë ndryshuar, përkatësisht janë reduktuar në 3 vite (kërkesa 5 dhe 6). Për me tepër në ankesë OE ankues ka potencuar se përvoja 3-5 vite është mjaftueshme. Ndërsa, lidhu me stafin e trajnuar në softuerët EPCS Software Kosovo ose iSBEMXX, OE ankues gjatë fazës së sqarimeve nuk kishte kërkuar sqarime. Në kërkesën për rishqyrtim dhe në ankesë përveç pretendimit se certifikimi në dy softuer është diskriminues nuk ka dëshmuar rrethanën se pse është diskriminuese dhe cilat janë certifikimet tjera valide për të cilat OE mund të përmbushë kërkesën në mënyrë ekuivalente. Andaj, sipas këtyre të sqarimeve pretendimi ankimor është i pabazuar.”

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Rregullorja e Punës së Organit të Shqyrtimit Publik, e cila gjendet e publikuar në Webfaqen e OSHP-së, me nenin 20, paragrafi 2 të Rregullores, përcakton kërkesat për Autoritetin kontraktues dhe Operatorin ekonomik, që të gjitha informatat dhe njoftimet duhen të dorëzohen dhe komunikohen përmes platformës së komunikimit publik, nëse kjo është e mundur.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtrësit e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues CONSTRUMAX SH.P.K. Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtues është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e eksperteve mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit dhe në këtë mënyrë është konstatuar se pretendimet e operatorit ekonomik ankues, CONSTRUMAX SH.P.K, janë të pa bazuara.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit "Fasadimi i Ndërtesave të vjetra në Kryeqytet si dhe Ofrimi i Shërbimeve" me nr. të prokurimit: "616-24-4375-2-1-1". Paneli shqyrtues vlerëson se eksperti shqyrtues ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e operatorit ekonomik ankues CONSTRUMAX SH.P.K dhe se, argumentimi në raportin e ekspertit është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit, sipas të cilit është konstatuar se pretendimet e operatorit ekonomik ankues, CONSTRUMAX SH.P.K, janë të pabazuara.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik CONSTRUMAX SH.P.K, refuzohet si e pa bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Fasadimi i Ndërtesave të vjetra në Kryeqytet si dhe Ofrimi i Shërbimeve" me nr. të prokurimit: "616-24-4375-2-1-1" të mbetet në fuqi, vendimi për dhënie të kontratës i autoriteti kontraktues Komuna e Prishtinës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Fasadimi i Ndërtesave të vjetra në Kryeqytet si dhe Ofrimi i Shërbimeve" me nr. të prokurimit: "616-24-4375-2-1-1".

Paneli duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjelloj sërish në detaje dhe pa nevojë në këtë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues. Krahas tjerash në raportin e ekspertit shqyrtues janë dhënë shpjegime profesionale dhe të argumentuara pa vërejtje lidhur me pretendimet ankimore, prandaj Paneli shqyrtues mbështet rekomandimin e ekspertit shqyrtues për mbetjen në fuqi të vendimit të autoritetit kontraktues Komunes Prishtinës.

Paneli shqyrtues thekson se konform nenit 1 dhe 6 të LPP, se Autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit publik, mirëpo mbetet në kompetencat dhe përgjegjësitë e këtij organi shqyrtimi i pretendimeve ankimore dhe ligjshmërisë në procesin e prokurimit sipas nenit 24, paragrafi 2 i LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj" lidhur me nenin 59,1 cituar "Autoriteti kontraktues do të themelojë një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës"

Paneli shqyrtues bazuar në faktin e refuzimit të ankese të OE CONSTRUMAX SH.P.K, vendosi të konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP, ndërsa mjetet të kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - CONSTRUMAX SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: